



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – RÉPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/101

Datë: 11.08.2022

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 5 dhe neni 44, neni 8 paragrafi 1, dhe neni 67 paragrafi 1.9 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 16 paragrafi 5 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenin 5, paragrafi 5 të Udhëzimi Administrativ (MSHTI) nr. 10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe neni 42, pika (a) të Statutit të komunës së Junikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

- I. z. Betim Gacaferi me nr. të let. 1230179235, nga Juniku, i emëruar mësimdhënës i lëndës së Gjuhës Angleze në SHFMU. "Edmond Hoxha" në Junik, i ndërpritet kontrata e Punës nga data 01.09.2022.
- II. Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës.

ARSYETIM

z. Betim Gacaferi me kualifikim shkollorë në Kolegjin AAB – 180 ECTS, ka nënshkruar kontratë pune të përhershme me nr. prot. 7-180/1435 me datën 04.03.2021 si mësimdhënës i lëndës së Gjuhës Angleze në SHFMU. "Edmond Hoxha" në Junik.

Andaj duke marrë parasysh bazen ligjore dhe Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm kjo kontratë bie ndeshë me normat e cekura më lartë.

Këshilla Juridike: Pala e pa kënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh. Ankesa i adresohet komisionit të ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publikë.

Me këtë vendim njoftohen:

- z. Betim Gacaferi,
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Arkiva.

